

VENDIM
Nr. 301, datë 10.4.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR GRUMBULLIMIN, MENAXHIMIN E
PËRDORIMIN E TË DHËNAVE NË SEKTORIN E PESHKIMIT DHE MBËSHTETJEN PËR
KËSHILLIMIN SHKENCOR PËR STRATEGJINË KOMBËTARE TË PESHKIMIT¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 93 pikat 4 e 5, e 135 pika 1 të ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e rregullave kuadër për:
 - a) mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave biologjike, teknike, mjedisore dhe social-ekonomike, në kuadër të programit shumëvjeçar, lidhur me sektorin e peshkimit, të krijuar sipas paragrafit 1 të nenit 93 të ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”;
 - b) përdorimin e të dhënave lidhur me sektorin e peshkimit në kuadër të strategjisë Kombëtare të Peshkimit (SKP), për qëllime të analizave shkencore;
 - c) përmirësimin e këshillimit shkencor, i nevojshëm për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Peshkimit (SKP).
2. Programi kombëtar hartohet për një periudhë trevjeçare.
3. Programi i parë kombëtar përfshin aktivitetet për vitet 2013 dhe 2015.
4. Përmbajtja e programit të kampionimit shumëvjeçar është parashikuar në shtojcën A bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Në programet e kampionimit shumëvjeçar përfshihen në veçanti:
 - a) plani i kampionimit për të dhënat biologjike, në bazë të kampionimit të kryer mbi flotën e peshkimit, duke përfshirë, kur është e nevojshme, edhe peshkimin çlodhës e argëtues;
 - b) plani i kampionimit të të dhënave në lidhje me ekosistemet, që lejon vlerësimin e impaktit të sektorit të peshkimit në ekosistemet detare dhe që shërben për monitorimin e gjendjes së ekosistemeve detare e ujore;
 - c) plani i kampionimit të të dhënave socio-ekonomike, që mundëson vlerësimin e situatës ekonomike të sektorit të peshkimit, analizën e rezultateve të tij në kohë dhe kryerjen e një analize të impaktit të masave që janë marrë ose që propozohen për zbatim.
6. Protokollet dhe metodologjia e përdorur për përcaktimin e programit të kampionimit kombëtar janë:
 - a) të qëndrueshme në kohë;
 - b) të ndara sipas zonave;
 - c) në përputhje me standardet cilësore të krijuara nga organizatat menaxhuese rajonale, në të cilat Shqipëria është palë kontraktore ose vëzhguese dhe nga institucionet kompetente shkencore

¹ Rregullore e Këshillit (EC) nr. 199/2008 e 25 shkurtit 2008, në lidhje me krijimin e një kuadri komunitar për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen e këshillimit shkencor në lidhje me politikën e përbashkët të peshkimit, Gazeta Zyrtare L 60, datë 5.3.2008 faqe 1.
Vendim i Komisionit i 18 dhjetorit 2009, që adopton një program komunitar shumëvjeçar për grumbullimin, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit për periudhën 2011-2013, njoftuar me numrin C (2009) 10121 (2010/93/UE), Gazeta Zyrtare L 41, datë 16.2.2010, faqe 8.

ndërkombëtare;
ç) të hollësishme.

KREU II AUTORITETET PËRGJEGJËSE

1. Ministria bashkërendon punën për programin kombëtar me shtetet e tjera të Adriatikut ose me shtetet ndërkufitare tokësore.

2. Ministria organizon takime rajonale koordinimi, me qëllim zbatimin e programeve të mbledhjes, të menaxhimit dhe të përdorimit të të dhënave në të njëjtin rajon.

3. Komiteti për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik (KKKSHTË), referuar nenit 22 të ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, vlerëson:

a) përputhjen e programit kombëtar me dispozitat e nenit 93 të ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”;
b) rëndësinë e të dhënave shkencore të përfshira në programin kombëtar, në përputhje me pikën 1 të kreut I të këtij vendimi.

4. KKKSHTË-ja vlerëson zbatimin e programeve kombëtare dhe cilësinë e të dhënave të mbledhura.

5. Kur KKKSHTË-ja vlerëson se programi kombëtar nuk përputhet me nenin 93 të ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin” ose kur çmon se programi kombëtar nuk garanton interesin shkencor të të dhënave ose cilësinë e metodave dhe procedurave të propozuara, propozon ndryshimet që i duhen bërë programit. Drejtoria paraqet një program kombëtar të rishikuar.

6. Ministria vlerëson zbatimin e programeve kombëtare në bazë të:

a) vlerësimit të KKKSHTË-së;
b) konsultimeve me organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit ku Shqipëria është palë.

KREU III KËRKESAT PËR PROCESIN E GRUMBULLIMIT TË TË DHËNAVE

1. Saktësia e të dhënave të mbledhura vlerësohet në mënyrë sistematike, sa herë që konsiderohet e nevojshme.

2. Ministria merr masa për të siguruar që personat e caktuar për marrjen e mostrave, të kryejnë funksionet e tyre, duke pasur akses në:

a) të gjitha pikat e zbarkimit, duke përfshirë, kur është e nevojshme, të gjitha transbordimet dhe transferimet në qendrat e akuakulturës;

b) të gjithë regjistrat detarë dhe tregtarë të mbajtur nga entet publike në lidhje me të dhënat ekonomike;

c) të dhënat ekonomike të bizneseve të lidhura me peshkimin.

3. Ministria, me qëllim mbledhjen e të dhënave në kuadër të programit kombëtar, harton dhe zbaton kontrollin në det dhe në ujërat e brendshme të peshkimit tregtar dhe atij çlodhës e argëtues.

4. Kapitenët e anijeve të peshkimit pranojnë në bord personat përgjegjës për kampionimet dhe që veprojnë në kuadër të kontrollit në det ose në ujërat e brendshme, të emëruar nga entet përkatëse dhe të ngarkuar për zbatimin e programit kombëtar. Kapitenët e anijeve bashkëpunojnë me personat përgjegjës për kampionimet me qëllim që këta të fundit të mund të kryejnë detyrat e tyre gjatë kohës së qëndrimit në bord.

5. Kapitenët e anijeve të peshkimit mund të refuzojnë të pranojnë në bord personat përgjegjës për kampionimet dhe që veprojnë në kuadër të kontrollit në det ose në ujërat e brendshme vetëm në rastet:

a) kur mungon hapësira akomoduese në anije; ose

b) që lidhen me sigurinë në bord, sikurse parashikohet në legjislacionin përkatës kombëtar.

Në këto raste, të dhënat mblidhen nëpërmjet një programi të vetëkampionimit, të kryer nga ekuipazhi i anijes së peshkimit dhe të hartuar e të kontrolluar nga entet e caktuara sipas pikave 3-5 të

kreut VII të këtij vendimi, për zbatimin e programit kombëtar.

6. Ministria mbështet studimet kërkimore në det dhe në ujërat e brendshme për të vlerësuar indekset e abondancës dhe shpërndarjen e popullatave të peshqve, pavarësisht nga të dhënat që vijnë nga peshkimi tregtar, si dhe për të vlerësuar impaktin e aktivitetit të peshkimit në mjedis.

KREU IV MENAXHIMI I TË DHËNAVE

1. Ministria, në funksion të menaxhimit të të dhënave, ushtron kompetencat si më poshtë vijon:

a) Siguron që të dhënat parësore të mbledhura në kuadër të programit kombëtar të mbahen në mënyrë të sigurt në një bazë të dhënash të kompjuterizuar dhe merr, gjithashtu, të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që trajtimi i tyre të jetë konfidencial;

b) Siguron që të dhënat e hollësishme të lidhura me të dhënat parësore social-ekonomike, të mbledhura në kuadër të programit kombëtar, të mbahen në mënyrë të sigurt në një bazë të dhënash të kompjuterizuar;

c) Merr të gjitha masat teknike, të nevojshme për të mbrojtur këto të dhëna ndaj çdo aksidenti ose shkatërrimi, humbjeje aksidentale, përkeqësimi, konsulence apo shpërndarjeje të paautorizuar.

2. Drejtoria, referuar në nenin 94 të ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, është përgjegjëse për cilësinë dhe tërësinë e të dhënave parësore të mbledhura në kuadër të programit kombëtar, sikurse edhe për të dhënat e hollësishme dhe parësore, të cilat u transmetohen përdoruesve finalë.

3. Drejtoria sigurohet që:

a) të dhënat parësore të mbledhura sipas programit kombëtar të jenë kontrolluara sipas procedurave të caktuara të kontrollit të cilësisë së tyre;

b) të dhënat e hollësishme dhe të përgjithshme, që rrjedhin nga të dhënat parësore të mbledhura në kuadër të programit kombëtar, të jenë njëvleftësuar përpara transmetimit të tyre te përdoruesit finalë;

c) procedurat e garantimit të cilësisë, që zbatohen te të dhënat e hollësishme dhe të përgjithshme, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, të jenë kryer në përputhje me procedurat e miratuara nga organizmat shkencorë ndërkombëtarë, organizatat e menaxhimit të peshkimit rajonal dhe KKKSHTE-ja.

KREU V PËRDORIMI I TË DHËNAVE TË MBLEDHURA NË KUADËR TË SKP-së

1. Dispozitat e këtij kreu zbatohen për të dhënat e mbledhura në kuadër të përcaktimeve:

a) të kapitullit XII të ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”;

b) të këtij vendimi për:

i) të dhënat për aktivitetin e anijeve të peshkimit, të mbledhura në kuadër të informacioneve të grumbulluara nga sistemi i kontrollit satelitor i anijeve të peshkimit ose nga sisteme të tjera kontrolli;

ii) të dhënat që lejojnë një vlerësim të besueshëm të volumit total të zënieve për popullata të peshqve nga lloje të ndryshme të peshkimit për lloje të ndryshme anijesh, për zona gjeografike dhe periudha kohore, duke përfshirë këtu edhe hedhurinat e peshkimit çlodhës-argëtues, kur është e nevojshme;

iii) të gjitha të dhënat biologjike të mbledhura për të vlerësuar gjendjen e popullatave të shfrytëzuara;

iv) të dhënat për ekosistemet, të nevojshme për të vlerësuar ndikimin e aktivitetit të peshkimit mbi ekosistemet ujore;

v) të dhënat social-ekonomike të sektorit të peshkimit.

2. Drejtoria eviton dublimet në grumbullimin e të dhënave në zbatim të pikës 2 të kreut IV të këtij vendimi.

3. Drejtoria merr masat që të dhënat primare të kërkimit shkencor në det dhe në ujërat e brendshme të dërgohen në organizmat shkencorë ndërkombëtarë dhe në entet shkencore të organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të miratuara.

4. Drejtoria përpunon të dhënat parësore në një set të dhënash të hollësishme ose të përpunuara, në përputhje me:

- a) standardet e rëndësishme ndërkombëtare, kudo ku ato ekzistojnë;
- b) protokollet e miratuara në nivel ndërkombëtar dhe rajonal, kudo ku ato ekzistojnë;

5. Drejtoria u siguron përdoruesve finalë, sa herë që është e nevojshme, një përshkrim të metodikës së zbatuar për të përpunuar të dhënat e kërkuara dhe për të drejtat e përdorimit nga ana statistikore të metodikave.

6. Drejtoria vë në dispozicion të përdoruesve finalë të dhënat e hollësishme dhe të përgjithshme për të mbështetur analizat shkencore:

- a) me qëllim që t'i shërbejnë gjykimit për menaxhimin e peshkimit;
- b) në interes të debatit publik dhe pjesëmarrjes së grupeve të interesit në hartimin e politikave, sikurse parashikohet në legjislacionin përkatës në fuqi;
- c) për publikime shkencore.

7. Drejtoria nuk jep të dhëna për përdoruesit finalë, në lidhje me aktivitetet e anijeve të peshkimit të marra nga monitorimi satelitor në zbatim të shkronjës “b” të pikës 4 të kreut V të këtij vendimi.

8. Transmetimi i të dhënave të hollësishme, të përpunuara në format elektronik, bëhet në mënyrë të sigurt.

9. Drejtoria merr masa që të dhënat e nevojshme, të hollësishme dhe të përpunuara për t'u dërguar mbi baza të rregullta, t'u dërgohen menjëherë organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit, në të cilat Shqipëria është palë ose vëzhguese, si dhe organizmave shkencorë ndërkombëtarë, në bazë të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.

10. Në rastet kur të dhënat e hollësishme dhe të përgjithshme kërkohen për qëllime të analizave shkencore specifike, drejtoria i dërgon te përdoruesit finalë:

- a) brenda një muaji nga data e marrjes së kërkesës, për rastet e parashikuara nga shkronja “a” e pikës 6 të kreut V të këtij vendimi;
- b) brenda dy muajve nga data e marrjes së kërkesës për rastet e parashikuara nga shkronja “b” e pikës 6 të kreut V të këtij vendimi.

11. Në rast se të dhënat e hollësishme dhe të përpunuara kërkohen për publikime shkencore sipas shkronjës “c” të pikës 6 të kreut V të këtij vendimi, drejtoria:

a) mund të mos shpërndajë të dhënat te përdoruesit finalë për një periudhë trevjeçare nga data e mbledhjes së tyre, me qëllim që të mbrojnë interesat profesionale të grumbulluesve të të dhënave. Në raste të justifikuara, ministria mund ta zgjatë këtë afat kohor;

b) kur përfundon afati trevjeçar, siguron që këto të dhëna t'u dërgohen përdoruesve finalë brenda dy muajve nga data e paraqitjes së kërkesës.

12. Drejtoria refuzon dërgimin e të dhënave të hollësishme dhe të përpunuara vetëm në rast se:

a) ekziston një rrezik real për identifikimin e personave fizikë dhe juridikë ose enteve ligjore të caktuara. Në këtë rast, drejtoria, për të përmbushur nevojat e përdoruesve finalë, propozon mënyra alternative të cilat sigurojnë anonimin;

b) përmbushen kushtet e përcaktuara në pikën 16 të kreut V të këtij vendimi;

c) këto të dhëna mund të sigurohen në një format tjetër, lehtësisht të arritshëm nga përdoruesit.

13. Në rastet kur të dhënat e kërkuara nga përdoruesit e tjerë, të ndryshëm nga organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit, ku Shqipëria është palë kontraktuese ose vëzhguese, si dhe nga organizmat e rëndësishëm shkencorë ndërkombëtarë, dhe kur këto të dhëna janë të ndryshme nga ato që u dërgohen këtyre institucioneve, ministria mund të kërkojë që përdoruesit finalë të mbulojnë kostot e mbledhjes së të dhënave dhe, nëse kërkohet, edhe të përpunimit të tyre para dërgimit të këtyre të dhënave.

14. Në rast refuzimi të dhënies së të dhënave nga ana e drejtorisë, përdoruesit finalë mund të ankohen në ministri. Nëse ministria çmon se refuzimi nuk ka qenë i justifikuar, atëherë të dhënat u jepen përdoruesve finalë brenda një muaji.

15. Përdoruesit finalë:

- a) përdorin të dhënat vetëm për qëllimet e parashikuara në kërkesën e tyre;

- b) citojnë në mënyrë korrekte burimin e të dhënave;
 - c) janë përgjegjës për përdorimin korrekt të të dhënave në lidhje me etikën shkencore sipas rregullave dhe legjislacionit në fuqi;
 - ç) informojnë drejtorinë në lidhje me problemet që mund të kenë të dhënat;
 - d) u japin drejtorisë dhe ministrisë rezultatet e nxjerra nga përdorimi i tyre;
 - dh) nuk u dërgojnë të dhëna palëve të treta pa miratimin e ministrisë;
 - e) nuk shesin të dhënat te palët e treta.
16. Nëse përdoruesit finalë nuk përmbushin kërkesat e pikës 15 të kreut V të këtij vendimi, drejtorja kufizon ose refuzon përdorimin e të dhënave nga këta përdorues.

KREU VI MBËSHTETJA PËR KËSHILLIMIN SHKENCOR

1. Ministria siguron që ekspertët kombëtarë të marrin pjesë në mbledhjet përkatëse të organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit, ku Shqipëria është palë kontraktuese ose vëzhguese, si dhe në organizmat e rëndësishëm shkencorë ndërkombëtarë.
2. Drejtorja bashkërendon punën dhe bashkëpunon me shtetet e tjera me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe të besueshmërisë së gjykimeve shkencore, cilësisë së programeve dhe metodave të punës në përputhje me standardet e organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit, ku Shqipëria është palë kontraktuese ose vëzhguese, si dhe në organizmat e rëndësishëm shkencorë ndërkombëtarë.
3. Ky bashkëpunim zhvillohet pa përjashtuar debatet shkencore të hapura dhe që kanë për qëllim promovimin e një gjykimi shkencor të pavarur.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ministria merr masat e nevojshme, teknike dhe financiare, për zbatimin e programeve kombëtare të kampionimit.
2. KKKSHTE-ja monitoron progresin e programeve kombëtare të kampionimit dhe përgatit mendimin për KKQPA-në.
3. Ngarkohet Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve për zbatimin e planeve të kampionimit sipas shkronjës “b” të pikës 5 të kreut I të këtij vendimi.
4. Ngarkohet Laboratori i Akuakulturës dhe Peshkimit i Universitetit Bujqësor të Tiranës, për zbatimin e planeve të kampionimit sipas shkronjës “a” të pikës 5 të kreut I të këtij vendimi.
5. Ministria mund të caktojë një ent tjetër, nëse enti i caktuar sipas pikave 3 dhe 4 të këtij kreu, dështon në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim.
6. Ngarkohet ministria, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve të Midhjeve dhe Peshkimit, sektorit të monitorimit dhe planifikimit në drejtori, si dhe monitorëve lokalë, për zbatimin e planeve të kampionimit, sipas shkronjës “c” të pikës 5 të kreut I të këtij vendimi.
7. Ngarkohet ministri të nxjerrë aktet nënligjore përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha